



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS RINAS

Nr. 9751/1 Prot.

Rinas, më 02.04.2024

Lënda: Kërkesë për shpallje publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANTFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHURAVE  
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, a) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar, pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor:

Vendimi Administratës		Vendimi Rikuperim me Forcë		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
Nr	Data	Nr	Data	Emri	Nipti/ID			
42	16.11.2023	750	11.03.2024	Marsilda Hoxha	J65623004G	207166	621498	828664

**KRYETAR**

Luan MEÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS RINAS

Nr. 750 Prot.

Rinas, më 11.03.2024

V E N D I M

PËR REKUPERIM ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR

Sot më datë 11.03.2024, unë Kryetari i Degës Doganore Rinas, në cilësinë e titullarit të organit administrativ, pasi shqyrtova të gjithë dokumentacionin që ndodhet në dosjen e Juristit/Specialistit të Borxhit doganor pranë kësaj dege doganore, që ka të bëjë me borxhin doganor të lindur me Vendimin Administrativ Nr. 42 datë 16.11.2023, ndaj shtetasës “Marsilda Hoxha”, me ID J65623004G, me adresë: Rr. “5 Shtatori, Çorovodë, Skrapar,

K O N S T A T O J S E:

Dega e Doganës Rinas me anë të Vendimit Administrativ Nr. 42 datë 16.11.2023, ka vendosur që shtetasja Marsilda Hoxha, të paguajë detyrim doganor shtesë dhe gjobë, pasi është kapur nga kontrolli doganor me sasi cigaresh të padeklaruara. (kontrabandë).

Dega e Doganës Rinas ka vendosur shpalljen debitor të subjektit për shumën 207166 (dyqind e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, detyrim doganor dhe 621498 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë gjobë.

Vendimi Administrativ Nr. 42 datë 16.11.2023, i është njoftuar subjektit debitor me shkresën Nr. 3300/1 datë 20.11.2023, me anë të postës zyrtare të regjistruar, për të cilën rezulton se subjekti Marsilda Hoxha, ka marrë dijeni në datën 24.11.2023 .

Subjekti nuk është paraqitur në Degën e Doganës Rinas dhe nuk ka kryer pagesën sipas afateve ligjore të përcaktuara.

Mbështetur në Nenin 133 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe Nenit 280 të Kodit Doganor, pas ezaurimit të afateve të njoftimit mbi vendimin administrativ, procedojmë me nxjerrjen e vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor.

Në këto kushte, me qëllim rikuperimin e borxhit doganor në shumën 207166 (dyqind e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, detyrim doganor dhe 621498 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë gjobë, së bashku me kamatë vonesat që shtetasja Marsilda Hoxha, ka ndaj Degës së Doganës Rinas, bazuar në Nenin 133 të Kodit të Procedurave Administrative, Nenin 280 të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile,

#### V E N D O S A :

1. Zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të borxhit doganor si dhe të detyrimeve të papaguara.
2. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të cmuar, dokumenteve me anë të të cilave bëhen pagesa, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit/subjektit Marsilda Hoxha, me ID J65623004G, personave të tretë apo garantuesit/ve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e paluajtshme që i përkasin debitorit/subjektit Marsilda Hoxha ID J65623004G, personave të tretë apo garantuesit/ve që kanë detyrime ndaj debitorit.
4. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuara në Vendimin Administrativ Nr. 42 datë 16.11.2023 të Degës së Doganës Rinas, të mbetur pa u shlyer prej 207166 (dyqind e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, detyrim doganor dhe 621498 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë gjobë, së bashku me kamatë-vonesat e lindura sipas Kodit Doganor deri në ditën e likujdimit të borxhit doganor.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe dërgohet për njoftim.

Bazuar në pikën 4 të Nenit 280 të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen Tituj Ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.

KRYETAR

Luan MEÇAJ

